

Mjesla Org:	013	Nr. Prot:	3923
Org. Jedinica:		Br. Prot:	
Org. Unit:		Data:	27. 10. 15
Nr. i faqesve:	2	Data:	
Br. stranica:		Data:	
No. pages:		Data:	
Prishtinë / s			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 26 tetor 2015

Ref. nr: 325/018

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), si dhe dispozitave të nenit 115 të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative (Gazeta zyrtare nr. 8, 1 janar 2007) nxjerr këtë:

**V E N D I M**


- I. PEZULLOHET zbatimi i paragrafit 3.5 i nenit 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (dt. 16 janar 2013).
- II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i MASht të njoftoj Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës për pikën 1 të këtij vendimi.
- III. OBLIGOHET Departamenti i Inspeksionit të Arsimit, që në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë të inspektoj zbatimin e këtij vendimi dhe kontrollin periodik të ligshmërisë në institucion.
- IV. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara dhe duke marr parasysh se paragrafi 3.5, Neni 11 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2013 mbi Akreditimin e Institucioneve të

Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, është në kundërshtim me nenin 67, paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212. Sa më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, *ministër*



**Iu dërgohet:**

- Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
- Të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë (publike dhe private);
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Arsimit të Lartë MASHT;
- Departamentit Ligjor, MASHT;
- Arkivit të MASHT.